



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Nr.\_\_\_\_ Prot.

Datë 05 / 02/2009

**VENDIM**

**Nr.101, Datë 05/02/2009**

**Për**

**Një Shtesë në Vendimin Nr. 88 datë 02. 10. 2008 “Për Hapjen e  
Procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Importit të Grurit dhe  
Prodhimit të Miellit”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05/ 02/ 2009, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Për një shtesë në Vendimin Nr. 88 datë 02. 10. 2008 të Komisionit të Konkurrencës

**Baza ligjore:**

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24 germa “d”

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

**VËREN SE:**

Grupi i Punës, për realizimin e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, gjatë veprimtarisë së tij, ndër të tjera, ka kërkuar informacione nga institucionet përkatëse për ndërmarrjet nën hetim.

Nga të dhënat e sjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe përpunimi i tyre ka rezultuar se në tregun e importit të grurit gjatë vitit 2008 ka hyrë dhe një ndërmarrje e re, “GLAN” SHPK, e cila për periudhën Shkurt – 31

Gusht 2008 zotëron 9 % të pjesës së tregut të importit të grurit duke zënë kështu një pjesë të konsiderueshme në treg.

Referuar Ekstraktit Historik të publikuar online nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, të datës 06. 01. 2009, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar si person juridik pranë QKR me Nr. K8141950D NIPT-i datë 19. 02. 2008, me seli në Durrës/Xhafzotaj, Godinë 1 katëshe Përballë ish – Metalikës. Kjo ndërmarrje ka si objekt të veprimtarisë së saj ndër të tjera dhe Import – Eksport të mallrave bujqësore.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të 24 germa “d” të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit;

### **VENDOSI:**

1. Ndërmarrja “GLAN” Sh.p.k të përfshihet në hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit.
2. Në pikën “I.” të pjesës urdhëruese të Vendimit Nr. 88 datë 02. 10. 2008 “Për Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Importit të Grurit dhe Prodhimit të Miellit” të shtohet pika 11. “GLAN” SHPK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **ANËTARËT**

**Lush PERPALI**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetar**

**Anëtare**

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETARE**